



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM  
Nr.24, datë 15. 12. 2017

PËR  
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SUBJEKTIT KOHA JONË NË LIDHJE ME DOMAIN  
kohajonë.al

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 15.12.2017, në mbështetje të nenit 114 dhe nenit 115 në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Drejtues (KD) të AKEP, miratuar me Vendim të KD Nr.7, datë 16. 02.2017, shqyrtoi çështjen me objekt:

- “Trajtimi i disa shqetësimeve lidhur me emrat e domain.AL”

**BAZA LIGJORE:**

1. Shkronja k) e nenit 8, të ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligj nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Rregullore Nr. 02, datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .Al dhe nën domain-et .gov, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” të ndryshuar (**Rregullore nr.02/2008**);

**KËSHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e administratorit dhe botuesit të gazetës "Koha Jonë", depozituar në AKEP me nr. 2268 Prot., datë 14. 12. 2017 (**Kërkesa**);
2. Relacionin shpjegues mbi trajtimin e çështjes të paraqitur nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimit Broadband, (**Relacioni**);
3. Projekt-Aktin vendimmarrës të Këshillit Drejtues në përfundim të shqyrtimit të çështjes;

si dhe:

- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;
- fakteve të paraqitura dhe analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E FAKTIT:

1. Administratori dhe botuesi i gazetës "Koha Jonë" (**Kërkuesi**) me shkresë nr. 2268 Prot., datë 14. 12. 2017 parashtron përpara AKEP pamundësinë për të fituar të drejtën e posedimit të emrit të domain nën .AL kohajonë.al duke aplikuar sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren nr. 02, për shkak se e drejta e posedimit të këtij emri domain është fituar nëpërmjet regjistrimit në AKEP në mënyrë abuzuese dhe të kundërligjshme nga një person tjetër, ndërkohë që emri Koha Jonë përbën një markë të regjistruar prej tij sipas ligjit nr. 9947, datë 07. 07. 2008 "Për pronësinë industriale" të ndryshuar.
2. Kërkuesi parashtron:
  - Gazeta "Koha Jonë" është e para gazetë e pavarur në Shqipëri, themeluar me 11 maj 1991, regjistruar më 11.03.1994 si subjekt tregtar "Koha Jonë shpk" me NIPT J71425013C dhe kohëzgjatje aktiviteti deri në vitin 2044.
  - Gazeta "Koha Jonë" që prej vitit 1999 publikohet edhe online me adresë elektronike [www.kohajonë.com](http://www.kohajonë.com).
  - Më datë 25.01.2016 gazeta "Koha Jonë" është pajisur nga organi kompetent me Certifikatë Regjistrimi Markë, për një periudhë 10 vjeçare.
  - Më datë 13.12. 2017, , për nevoja pune të vetë subjektit "Koha Jonë", ka aplikuar sipas procedurës online të AKEP për të fituar të drejtën e posedimit të domain nën .al., kohajonë.al. Përgjigja e AKEP ishte se subjekti "Koha Jonë" nuk mund ta fitojë të drejtën e posedimit të domain kohajonë.al pasi ky domain nën .al është i regjistruar në emër të një poseduesi person natyror që prej datës 16.12.2013.
  - Këtë fakt, si dhe faktin që nga komunikimi me poseduesin e domain kohajonë.al rezultoi se ky i fundit i ka kërkuar që mund t'ia transferojë domain kundrejt një pagese, administratori dhe botuesi i subjektit KOHA JONË shpk e kundërshton duke e konsideruar të paligjshëm dhe abuziv.
  - Kërkuesi në shkresën drejtuar AKEP nr. 2268 Prot., datë 14. 12. 2017, kërkon ndërhyrjen e AKEP për heqjen e domain kohajonë.al nga posedimi i personit natyror ekzistues dhe kalimin e tij në posedim të subjektit KOHA JONË si subjekt që i përket kjo e drejtë për shkaqet e parashtruara më sipër.

## II. KONSTATIMET DHE ARSYETIMI I AKEP

1. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi si dhe akteve që disponon AKEP rezulton se domain kohajonë.al është regjistruar dhe posedohet nga një subjekt natyror që prej datës 16.12.2013, sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren nr 02/2008.
2. Nga verifikimi i bërë në faqen e internetit të subjektit natyror të mbështetur në këtë domain [www.kohajonë.al](http://www.kohajonë.al) është publikuar një njoftim për shitje të këtij domain në ankand. Ky fakt bie ndesh me përcaktimin e parashikuar në pikën 11.2 të nenit 11 të Rregullores 02/2008 sipas të cilës “Poseduesi, mund ta përdorë emrin e domain-it në përdorim, vetëm për sa parashikohet dhe përcaktohet në këtë Rregullore. Në rregulloren 02/2008 nuk parashikohet e drejta e poseduesit për shitjen në ankand të domain që posedon. Për këtë arsye AKEP, si organ kompetent përgjegjës, ky fakt përbën shkelje të kësaj rregullore.
3. Në rrethanat e cituara në pikën 2 të mësipërme, duke patur parasysh edhe rregullin e përcaktuar në pikën 25.1 të nenit 25 të Rregullore nr. 02/2008 sipas të cilës parashikohet që “Autoriteti Përgjegjës (AKEP) bllokoi emrin e domain-it në çdo rast që identifikon një shkelje të kushteve apo kritereve të përcaktuara në këtë Rregullore, sipas rasteve të mëposhtme, por pa u kufizuar në to:...”, AKEP gjykon se rasti ndodhet në konditat e parashikuara në këtë dispozitë dhe vendosja e masës së bllokimit të emrit të domain kohajonë.al ndaj poseduesit person natyror ekzistues, është e legjitimuar dhe e drejtë.

### P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të shkronjës k) të nenit 8, pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, ligjit nr. 44/2015 dhe nenit 11 dhe 25 të Rregullores nr. 02/2008;

### V E N D O S:

1. Bllokimin e emrit të domain kohajonë.al sipas parashikimeve të Rregullores nr. 02/2008.
2. Vendimi të publikohet në faqen elektronike të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al) dhe të njoftohen palët e interesuara.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimit Broadband.

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

## KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

**Ilir Zela**

**ANËTARË:**

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Anila DENAJ**
- 3. Ketrin TOPÇIU**
- 4. Klarina ALLUSHI**